

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Të nderuar koleget e mi deputetë,

Të dashur qytetarë shqiptarë që po na ndiqni në këtë seancë maratonë,

Në fakt, nga njëra anë ndihem mirë, e nderuar dhe e vlerësuar të përfaqësoj qarkun e Lezhës në këtë parlament, sepse është privilegj, por edhe përgjegjësi shumë e madhe të përfaqësoj ata banorë, të cilët mbështetën dhe votuan masivisht ndryshimin, votuan Partinë Demokratike. Por, njëkohësisht, ndihem edhe keq në një parlament, ku një numër i konsiderueshëm deputetësh, janë këtu pa vullnet të lirë të njerëzve, pa votë të pastër, por me blerje vote, me para të hedhura lumë dhe me trysni nga shteti kundër popullit.

Zgjedhjet e lira dhe vota e lirë janë mekanizmi për të treguar se cilin preferon populli dhe jo mekanizmi për të treguar se kush e blen më shtrenjtë popullin, kush e frikëson më shumë popullin e kush e manipulon më mirë votën. Kur ndodh që pushteti nuk fitohet me votë, por merret me lekë dhe me shtet, edhe partia që e merr pushtetin nuk përfaqëson më votën e popullit, nuk përfaqëson më interesat e popullit. Pasojat e kësaj maskarade fillojnë e shfaqen shumë shpejt; qeveria nuk funksionon më për njerëzit, por vetëm për një grusht njerëzish. Nuk punon më as për ekonominë familjare e kombëtare, as për të punësuarit e as për të papunët, as për të varfrit e as për ata që janë në rrezik për t'u varfëruar çdo ditë, nuk punon as për fermerin, as për shitësin e as për punëtorin e krahut. Qeveria nis e punon për ata që kanë blerë votat, për ata që kanë përdorur shtetin në terren, për ata që kanë ndihmuar në marrjen e pushtetit me zor. Nis e ndan tenderë, ndan rroga, ndan leje legalizimi, ndan toka publike dhe të gjitha llojet e favoreve, sepse atyre ua ka borxh pushtetin. Pushteti me votë të pastër prodhon një qeverisje të pastër. Ndërsa pushteti me votë të pistë do të prodhojë një qeverisje të pistë. Ne e dimë që rilindësit e ënjtur nga pushteti përpiqen të gjejnë një justifikim, thonë: "Vota nuk u ble; shteti nuk u përdor; banditët nuk ishin aty për zgjedhje.". Kjo është e pritshme. Madje, na thonë: "Ku i keni provat, nxirrni videot, nxirrni fotot, nxirrni faktet!".

Është e vërtetë që ne kemi pak raste, në krahasim me atë çfarë realisht ka ndodhur, sepse këta janë specialistë. Por kemi ndaluar makina me para, me karta identiteti, furgonë me ushqime, duke blerë vota me rezervat e shtetit. Ne kemi pak, shumë pak nga e gjithë maskarada zgjedhore, por OSBE-ODIHR-i u shpreh qartë e pastër: zgjedhjet u blenë! Edhe vetë shqiptarët e dinë. Kudo nëpër qytetet e fshatrat tona njerëzit e dinë mirë se kush ishte, kush bleu, për kë punoi dhe kë bleu. Njerëzit në Lezhë, Kurbin dhe Mirditë e dinë se kush i bleu votat, duke paguar 2000 euro për familje dhe duke ua listuar shtëpitë si gjoja të prekura nga tërmeti. Njerëzit e dinë mirë se kush i shpërndau zarfet me nga 500 euro. Edhe vetë rilindësit e socialistët e dinë mirë kush ua mundësoi pushtetin. Por atyre nuk u bën më asgjë përshtypje, ata janë gati ta mbajnë e ta përdorin pushtetin ilegjitim që kanë grabitur. E jo vetëm kaq, këta mendojnë se na sikletosin kur nxjerrin në emisione televizive xhandarët analistë, të cilët na thonë: "Pse futeni në parlament nëse nuk i njihni zgjedhjet si legjitime". Ne futemi në parlament, sepse parlamenti është yni, parlamenti nuk është shtëpia e Ramës. Ne jemi këtu në shtëpinë e shqiptarëve, sepse ata na kanë mandatuar për të folur në emrin e tyre, me zërin dhe gojën e tyre. Edhe sipas kulturës parlamentare botërore, parlamenti është më shumë i opozitës se sa i qeverisë. Qeveria, po ta kishte në dorë, do ta mbyllte parlamentin e do të sundonte nga zyrat qeveritare. Prandaj, mund ta themi me plot gojën se parlamenti i takon më shumë opozitës, dhe ju

ftoj ta respektoni këtë parim. Mos mendoni se keni numrat dhe do të veproni me forcën e numrave apo me pushtetin e votës. Demokracia nuk është forcë e numrave, por është forcë e parimeve demokratike. Të dashur qytetarë, Ne sot gjendemi përballë një varfërie therëse. Sot janë shtrenjtuar çmimet e ushqimeve; është shtrenjtuar buka, djathi, vaji, makaronat dhe çdo produkt tjetër. Janë rritur faturat e energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm. Sot njerëzit kanë më pak akses në shëndetësi dhe këtë e pamë në menaxhimin e pandemisë, ku njerëzit fushin miq për të gjetur një bombol oksigjeni. Ilaçet dhe mjekimi, që u kushtoi shumë shtrenjtë, nuk ua rimbursoi askush, por të gjitha i paguan vetë. Kjo ndodh sepse sistemi shëndetësor nuk funksionon për njerëzit, por funksionon si ndërmarrje biznesi për koncesionet dhe për marrje parash nën dorë. Sot shkollimi është më pak cilësor. Sot prindërit ankohen për nivelin arsimor në sistemin publik, pasi nuk kanë para për t'i dërguar fëmijët në privat dhe pa dyshim as për t'i shkolluar jashtë Shqipërisë, siç po i shkolloni ju fëmijët tuaj. Sot shqiptarët duhet të paguajnë me shtrenjtë për të jetuar në këtë vend të pajtueshëm dhe të pashpresë, dhe kjo është mërita juaj.

Sot dhuna në familje është rritur frikshëm. Gratë dhe vajzat shqiptare vuajnë pasojat e nervave dhe të dëshpërimit të burrave të papunë; vuajnë papunësinë e tyre, gjithashtu; vuajnë rrogat qesharake e shfrytëzuese, kudo ku punojnë; vuajnë mungesën e mbështetjes dhe të mbrojtjes nga shteti inekzistent. Çfarë përgjigjeje kemi ne si parlament apo ju si qeveri për këtë situatë dramatike? Përgjigjja e Ramës, sigurisht, është programi i qeverisë, të cilin na e ka sjellë sot për votim. Së pari, dua të them se ky program nuk është dhe nuk mund të quhet program. Nuk ka se si të jetë program as politikisht dhe as teknikisht. Ky është një formalitet, i cili duhet kryer sa për procedurë për dekretimin e qeverisë dhe vetëm kaq. Në këtë pamflet, që Rama e quan program, ka vetëm fjali të përgjithshme, fjali propagandistike, të cilat i përdor prej 8 vjetësh. Ky program ka vetëm një fjalë: "rilindje". Rilindja deri me sot ka rezultuar se është rilindje e sistemit enverist; ka rezultuar se është rilindje e dhunës mbi njerëzit; rilindje e trajtimit të njeriut si skllav; rilindje e arrestimit të padrejtë; rilindje e dhunës policore nëpër lagjet e Shqipërisë; rilindje e konceptit, sipas të cilit paratë e njerëzve konsiderohen si të shtetit dhe shteti konsiderohet si pronë private e Kryeministrit. Duke i konsideruar paratë e shqiptarëve si para të vetat, shqiptarët do ta shohin se cili do të jetë programi i vërtetë në terren e në përditshmërinë e tyre dhe jo në letra e në pamflete. Programi real i kësaj qeverie tashmë dihet dhe është i njohur për çdo shqiptar. Qeveria vetëm tenderon; tenderon për miq, për klientë dhe familjarë. Ajo paguan për militantë, për mbështetës, për blerës votash, për banditët e shumtë rreth saj. Të gjitha paratë, të cilat duhet të shkonin për ekonominë, për zhvillimin, për arsimin, për shëndetësinë, për zbutjen e pasojave sociale shkuan për njerëzit e afërt të oborrit qeveritar. Ne nuk kemi asnjë shpresë se kjo qeveri do të ndryshojë. Nuk shpresojmë se do të bëjë ndonjë gjë tjetër, përveç asaj që ka bërë në këta 8 vjet. Modeli i saj tashmë është modeli i grabitjes dhe i zhvatjes. Programi i vetëm dhe i pandryshueshëm i saj është mbledhja e parave të shqiptarëve dhe shpërndarja e tyre te klientët qeveritarë. Edi Rama nuk ka ndër mend të heqë dorë nga ky model apo ta ndryshojë këtë program. Por ne do të jemi këtu për të folur për interesat e gjera ekonomike e sociale të shqiptarëve, për të përfaqësuar ata njerëz, të cilët duan të jetojnë në një Shqipëri të punës së ndershme; në një Shqipëri të jetesës së qetë; në një Shqipëri ku ka mundësi për të jetuar e punuar.

Ne do të jemi këtu për të përfaqësuar dhe promovuar programin e vërtetë që i duhet Shqipërisë, sepse ne jemi alternativë e modelit të Ramës. Ne mundemi të bëjmë më të mirën për shqiptarët, që kjo qeveri e kjo maxhorancë nuk mundet dhe nuk e ka vullnetin për ta bërë. Faleminderit!